



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.325/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Laziq dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesat e Fidan Mustafës nga Lëvizja për Drejtësi, dega në Lipjan, kundër Koalicioni LDK-AKR, për shkak të manipulimit të votave brenda koalicionit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të pas afatshme ankesat Anr.325, Anr.326 dhe Anr.327, Anr.328, Anr.329 dhe Anr. 330 të datës 13.06.2017 e ankuesit Fidan Mustafës nga Lëvizja për Drejtësi, dega në Lipjan-Koalicioni LDK-AKR, të parashtruara kundër Koalicionit LDK-AKR-dega në Lipjan.

A r s y e t i m

Me datën 13.06.2017, PZAP-i ka pranuar gjashtë ankesa nga Fidan Mustafa nga Lëvizja për Drejtësi, dega në Lipjan-Koalicioni LDK-AKR, në të cilat pretendon se në ditën e votimit me datën 11.06.2017 kanë dyshimet e bazuara se janë manipuluar votat brenda Koalicionit LDK-AKR sepse numri i votave të cilat kanë dalur nëpër regjistra të KQZ-së është i përgjysmuar në krahasim me numërin e fletëvotimeve të cilat gjenden në kutit e votimit. Në ankesë parashtruesi i ankesave kërkon që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve pasi që i njëjti ka dyshime për manipulime me numërin e votave në kutit e votimit dhe regjistrat e KQZ.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartëcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me Anr 325/2017 për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për tre ankesat vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesave gjeti se:

Ankesat janë të pas afatshme

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 5 par.3 Rregullorës Nr.02/2015 Rregullat dhe Procedurat. Në rastin konkret ankesat nga parashtruesi i ankesës janë dorëzuar në PZAP, me datë 13.06.2017. Nga përmbajtja e ankesave rezulton se

të gjitha pretendimet ankimore të parashtruar nga ankuesit në ankesat Anr. 325/2017, Anr. 326/2017, Anr. 327/2017, Anr. 328/2017, Anr. 329/2017, Anr. 330/2017 të datës 13.06.2017, ndërlidhen me parregullsitë gjatë procesit të votimit, në ditën e votimit të datës 11.06.2017.

Nga kjo rezulton se ankesat e lartpërmendur janë dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjore për të parashtruar ankesa në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së nenit 5 par.3 të Rregullorës Nr.02/2015 Rregullat dhe Procedurat, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 12.06.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesit ankesat e tyre i kanë parashtruar në PZAP me datë 13.06.2017, që do të thotë se ankesat janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5.3, Rregullorës sipërcituar.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.325/2017 më datën 14.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.